



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake
Gjykatësi Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 30 korrik 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Version i Redaktuar Publik i Vendimit të Dytë mbi Kërkesën e Prokurorit të
Specializuar për Paraqitjen e Materialit Mbështetës Shtesë**

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit

Dejvid Hupër

Mbrojtësit të Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit

Dejvid Jang

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në pajtim me nenin 39(2) dhe 3, të Ligjit nr. 05/L-053 “Për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuara” (“Ligji”) dhe me rregullat 85(5), dhe 86(3) dhe 4(a), të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomës së Specializuar të Kosovës (“Rregullorja”), vendosi:

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 24 prill 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) paraqiti për konfirmim një aktakuzë rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* (“Aktakuza”), së bashku me materialin provues në mbështetje të akuzave si dhe një përmbledhje të detajuar që paraqiste lidhjen e secilës provë me secilën akuzë.²
2. Më 17 qershor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i dha leje ZPS-së të paraqiste material shtesë në mbështetje të Aktakuzës.³
3. Më 24 korrik 2020, me urdhër të Gjykatësit të Procedurës Paraprake,⁴ ZPS-ja dorëzoi një aktakuzë të rishikuar (“Aktakuza e Rishikuar”).⁵
4. Më 29 korrik 2020, ZPS-ja kërkoi leje për të paraqitur material shtesë në mbështetje të Aktakuzës së Rishikuar (“Kërkesa”).⁶ Në këtë material përfshihen deklarata e një të dyshuari që është objekt i Aktakuzës së Rishikuar, e dhënë më 13 deri 16 korrik 2020,⁷

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00002, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës për Konfirmim*, 24 prill 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcat 1-3, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

³ KSC-BC-2020-06, F00007, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorit për Paraqitjen e Materialit Mbështetës Shtesë*, 17 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

⁴ KSC-BC-2020-06, F00010, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër Prokurorit të Specializuar në pajtim me Rregullën 86(4) të Rregullores*, 2 korrik 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

⁵ KSC-BC-2020-06, F00011, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Rishikuar për Konfirmim*, 24 korrik 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁶ KSC-BC-2020-06, F00012, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e Dytë për Paraqitjen e Materialit Mbështetës Shtesë*, 29 korrik 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

⁷ [REDAKTUAR] (339 faqe gjithsej).

dhe dokumente të tjera të përdorura gjatë intervistës me të dyshuarin, që nuk qenë dorëzuar më parë⁸ (bashkërisht të quajtura, “Material Mbështetës Shtesë”). ZPS-ja parashtron se Materiali Mbështetës Shtesë i siguruar së fundmi, ka kuadër dhe kohëzgjatje të kufizuar dhe ka lidhje me akuzat e Aktakuzës së Rishikuar.⁹

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

5. Neni 39(20, i Ligjit parashikon se Gjykatësi i Procedurës Paraprake e shqyrton aktakuzën, dhe, sipas rregullës 85(5) të Rregullores, merr një vendim për këtë shqyrtim jo më vonë se gjashtë muaj nga dorëzimi i aktakuzës dhe i të gjithë materialit mbështetës.

6. Sipas rregullës 86(3), të Rregullores, aktakuza dorëzohet së bashku me materialin mbështetës që përmban një përmbledhje të detajuar ku tregohet lidhja e çdo prove me secilën akuzë.

7. Sipas rregullës 86(4)(a) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të lejojë Prokurorin e Specializuar të dorëzojë material shtesë në mbështetje të cilësdo ose të gjitha akuzave.

⁸ Prova materiale 17: [REDAKTUAR] (3 faqe); Prova materiale 19: [REDAKTUAR] (2 faqe); Provat materiale 21 dhe 22: [REDAKTUAR] (3 faqe) dhe [REDAKTUAR] (3 faqe); Prova materiale 23: [REDAKTUAR] (1 faqe); Prova materiale 26: [REDAKTUAR] (2 faqe) dhe [REDAKTUAR] (2 faqe); Provat materiale 27 dhe 28: [REDAKTUAR] (1 faqe), [REDAKTUAR] (2 faqe) dhe [REDAKTUAR] (1 faqe); Prova materiale 29: [REDAKTUAR] (3 faqe); Prova materiale 30: [REDAKTUAR] (2 faqe); Prova materiale 31: [REDAKTUAR] (8 faqe); Prova materiale 32: [REDAKTUAR] (2 faqe); Prova materiale 33: [REDAKTUAR] (1 page); Prova materiale [REDAKTUAR] (2 faqe); Provat materiale 37 dhe 38: [REDAKTUAR] (3 faqe) dhe [REDAKTUAR] (3 faqe); Prova materiale 40: [REDAKTUAR] (1 faqe); Prova materiale 41: [REDAKTUAR] (10 faqe); Prova materiale 44: [REDAKTUAR] (2 faqe); Provat materiale 45 dhe 46: [REDAKTUAR] (9 faqe) dhe [REDAKTUAR] (9 faqe); Prova materiale 47: [REDAKTUAR] (14 faqe); Prova materiale 48: [REDAKTUAR] (4 faqe); Prova materiale 49: [REDAKTUAR] (9 faqe); Prova materiale 50: [REDAKTUAR] (1 page); Prova materiale 51: [REDAKTUAR] (3 faqe); Prova materiale 52: [REDAKTUAR] (8 faqe); Prova materiale 53: [REDAKTUAR] (4 faqe); Prova materiale 54: [REDAKTUAR] (1 faqe).

⁹ Kërkesa, para 5.

III. DISKUTIM

8. Gjatë marrjes së një vendimi për t'i lejuar ZPS-së të paraqesë për herë të dytë material shtesë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të sigurohet sidomos që i gjithë shqyrtimi i procesit të aktakuzës të përfundojë brenda afatit të parashikuar në rregullën 85(5), të Rregullores.

9. Pavarësisht nga fakti se Kërkesa është dorëzuar më shumë se tre muaj pas Aktakuzës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se, në rrethanat e tanishme, Kërkesa është në kohë, po të mbahet parasysh se intervista me të dyshuarin në fjalë është kryer jo më larg se përpara dy javësh. Pavarësisht nga volumi i konsiderueshëm i Materialit Mbështetës Shtesë,¹⁰ kjo Kërkesë nuk e vë në rrezik afatin gjashtëmuor të parashikuar në rregullën 85(5), të Rregullores, për marrjen e një vendimi mbi shqyrtimin e Aktakuzës së Rishikuar.

10. Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu vëren se Materiali Mbështetës Shtesë i paraqitur konsiston në deklaratën e të dyshuarit dhe dokumentet e diskutuara gjatë intervistës, që kanë lidhje *prima facie* me akuzat e ngritura në Aktakuzën e Rishikuar.

11. Bazuar në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i lejon ZPS-së të paraqesë Materialin Mbështetës Shtesë.

12. Krahas kësaj e për pasojë nga sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i jep urdhër ZPS-së të përgatisë një plotësues të përmbledhjes të dorëzuar më parë në bazë të rregullës 86(3)(b), ku të dëshmohet lidhja e Materialit Mbështetës Shtesë me çdo akuzë faktike që përmbush kriteret përkatëse juridike të veprës apo veprave penale, përfshirë edhe elementet kontekstuale dhe/ose kategoritë e përgjegjësisë penale, sipas rastit.¹¹

¹⁰ Materiali Mbështetës Shtesë përmban 458 faqe gjithsej.

¹¹ Lidhja e materialit mbështetës dëshmohet duke treguar paragrafin/paragrafët ose faqen/faqet specifike që përmbajnë informacionin me të cilat përmbushen kriteret juridike, duke përjashtuar kështu

IV. VENDIMI

13. Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **MIRATON** Kërkesën; dhe
- b. **URDHËRON** ZPS-në të paraqesë një plotësues ndaj përmbledhjes së dorëzuar sipas rregullës 86(3)(b), siç përshkruhet në paragrafin 11, brenda të hënës, 24 gusht 2020.

/nënshkrim/

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatësi i Procedurës Paraprake

E enjte, 30 korrik 2020
Hagë, Holandë.

informacion të përgjithshëm dhe kontekstin. Saktësia e përmbledhjes së dorëzuar në bazë të rregullës 86(3)(b), ndihmon për një analizë të përshpejtuar të materialit mbështetës.